



## K435 Knauf Flächendicht / Flächendichtband

Solucion hidroizolimin e sipërfaqes / Shirit izolues për bashkimet

### Knauf Flächendicht

#### Materiali

##### Ndërtimi i materialit

Knauf Flächendichtband është një masë izoluese me bazë sintetike dhe me material mbushës inerte. Nuk përmban asnjë substancë tretëse dhe i padëmshëm fiziologjikisht. Përpunimi si dhe zbatimi nuk i nënshtrohen asnjë kufizimi si pasojë e klasifikimit si material i dëmshëm. Pas tharjes krijohet një shtresë hidroizoluese, elastike.

##### Magazinimi

Knauf Flächendicht magazinohet në vende pa ngrica. Koha e magazinimit në paketim origjinal e mbyllur rreth 12 muaj.

##### Të dhëna mbi porosinë

Knauf Flächendicht

5 kg Kova

Nr.Materialit. 00007366

#### Fushat e përdorimit

Knauf Flächendicht përdoret për izolimin e sipërfaqeve nën shtresat e pllakave qeramike. Vendoset pothuajse në të gjitha sipërfaqet si p.sh beton, porobeton, suva me bazë gëlqere, gipsi, çimento, pllaka gipsi, çimentato, fibër-gipsi, mur tulle, dysheme me bazë çimento, guri, anhidriti, druri.

#### Karakteristikat

- përdorimi i thjeshtë.
- aftësi të mira ngjitëse mbi të gjitha sipërfaqet ndërtuese
- pa substancë tretëse, e padëmshme
- hidroizoluese, e qëndrueshme ndaj ujit agresiv, rezistente nga mikrobet
- e depëtueshme nga avulli, me aftësi të ulët avull-frenuese
- aftësi e lartë elastike në temperatura të larta, gjithashtu edhe në temperaturat e ngrirjes deri - 20 °C
- rezistente në temperaturë rreth + 80 °C
- shumë e qëndrueshme në kohë
- mbulon plasaritje deri 2 mm

# K435 Knauf Flächendicht / Shiriti Flächendichtband

Masë izolimin e sipërfaqeve / Shiriti izolues cepat, këndet dhe bashkimet



## Knauf Flächendicht

### Përpunimi

#### Sipërfaqja e punueshme

- Sipërfaqja e punueshme duhet të jetë e fortë, e pastër, e thatë dhe pa shtresa yndyre apo solucione ndarëse. Mbeturinat si, pluhur, llak dhe llaç duhet të mënjanohen.
- Të stukohen fugat dhe plasaritjet.
- Të mbyllen (izolohen) të gjitha vendet nga ku uji mund të depërtojë (mur ose dysheme)

#### Zbatimi

- Para përdorimit përzihet
- Sipërfaqja lyhet e plotë me Knauf Flächendicht (hollimi me ujë në raportin 1:4) me furçe, penel ose rrul dhe lihet të thatet plotësisht. Sipërfaqet e dyshemesë (me bazë anhidriti, beton, element i gatshëm) mund të paratrajtohen si alternative edhe me Knauf Estrichgrund (hollimi me ujë 1:1).
- Mbi dyshemenë Knauf Stretto, Knauf Flächendicht lyhet pa u paratrajtuar më parë me ndonjë primer tjetër. Këtu Knauf Flächendicht hidhet i paholluar.
- Janë të domosdoshme të paktën edhe dy shtresa të tjera lysterje të paholluara.

- Në zonat e bashkimit në murin dhe tek këndet, në lysterje e parë të paholluar, vendoset shiriti Knauf Flächendichtband dhe ngjishet fort.
- Për sipërfaqet poroze si p.sh. porobeton këshillohet lysterje me 3 duar me solucion të paholluar.
- Mbani parasysh sasinë minimale të harxhimit. (shiko harxhimi e materialit)

#### Koha e përpunimit

- Menjëherë pas tharjes së çdo shtrese vijon lysterja me shtresat vijuese.
- Koha minimale e pritjes: rreth 2-3 orë (për temperaturë +20 ° C dhe lagështi relative ajri 50 %).
- Për lagështi ajri më të madhe si dhe për temperatura më të ulta, koha e tharjes mund të zgjatet.

#### Temperatura e përpunimit / sipërfaqes

+5 °C deri +25 °C (e leverdisshme: mbi +10 °C).

#### Udhëzime plotësuese

- Shtrimi i pllakave mbi Knauf Flächendicht duhet të kryhet me një kollë rezistente ndaj ujit (p.sh. Knauf Flexkleber)
- Kollërat për pllakat e gatshme dispersion nuk janë të përshtatshme!
- Knauf Flächendicht mund të ngjyroset me pigmentë normale në treg (deri maks. 2% e peshës).
- Koha e tharjes para fillimit të shtrimit të pllakave rreth 12 orë.

#### Sasia e materialit

Sasia e nevojshme e materialit varësisht nga ashpërsia e sipërfaqes si dhe plotësimi të kërkesave për hidroizolim.

Sasia minimale e nevojshme:

- mbi sipërfaqe të sheshta (p.sh. Pllakë Knauf): rreth 750-900 g/m<sup>2</sup>, Sasia minimale për çdo shtresë: 250 - 300 g/m<sup>2</sup>
- mbi sipërfaqe të ashpra (p.sh. Beton): rreth 900-1400 g/m<sup>2</sup>, Sasia minimale për çdo shtresë: 300 - 450 g/m<sup>2</sup>

## Shiriti Knauf Flächendichtband

### Materiali

#### Ndërtimi i materialit

Shiriti Knauf Flächendichtband është një rrjetë poliestër me trashësi 7 cm, elastike, i përforcuar, ngjyrë gri. Ai shërben si shtresë hidroizoluese.

#### Magazinimi

Shiriti Knauf Flächendichtband magazinohet në temperaturë ambiente.

#### Të dhëna mbi porosinë

Knauf Flächendichtband

10 m Rrul

Nr. Materialit 00005356

### Fusha e përdorimit

Shiriti Knauf Flächendichtband përdoret sëbashku me primer-in Knauf Flächendicht për të arritur një hidroizolim të sigurtë në vendet kritike.

- Këndet e jashtme të brendshme/të jashtme
- Bashkimet në dysheme / mur
- Të çarat dhe plasaritjet të izolohen para vendosjes së primer-it me stuko

Për izolimin kundër ujit me presion dhe pa presion duhet të mbahen parasysh rregullat teknike të vlefshme si dhe normat (DIN 18195).

### Karakteristikat

- merr formë
- aftësi elastike të mira
- e qëndrueshme në kohë
- lehtësisht e fiksueshme

### Përpunimi

- Shiriti Flächendichtband ngjitet para vendosjes së shtresës së parë të paholluar me Knauf Flächendicht.
- Shiriti izolues fiksohet mbi shtresën e parë të holluar me Knauf Flächendicht. Shtresa duhet të jetë e pastër dhe shiriti vendoset pa rrudha në zonat e këndeve dhe cepave dhe lyhet me shtresën e dytë si dhe të tretë të paholluar Knauf Flächendicht.

- Në zonat e mbivendosjes së shiritit, p.sh. në cepa, kërkohet që shiriti të mbivendoset të paktën 5 cm dhe të ngjishet fort.

- Pas izolimit shtesë me shiritin Knauf Flächendichtband e gjithë sipërfaqja lyhet përsëri me primer-in Knauf Flächendicht, e sidomos në zonat e vendosjes së shiritit dhe në zonat e bashkimit, primer-i vendoset në sasi të bollshme.